



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

**KUSHTET PËR KTHIM/RIPARIM TË PRODUKTEVE "OPEN BOX"**

EMRI I KLIENTIT: \_\_\_\_\_ DATA E BLERJES: \_\_\_\_\_  
ADRESA / NUMËR  
TELEFONI: \_\_\_\_\_  
TIPI, MODELI I  
PRODUKTIT: \_\_\_\_\_ IMEI/ESN/SN: \_\_\_\_\_

NËNSHKRIMI DHE VULA E SHITËSIT TË PRODUKTIT

\_\_\_\_\_

**GARANCI E KUFIZUAR E OFRUAR NGA PRODHUESI**

Me qëllim lehtësimin e procedurave të kthim/riparimit të pajisjeve të ofruara nga prodhuesit e produkteve dhe për t'i qëndruar sa më afër nevojave të blerësve të paketave të produkteve të blera pranë dyqaneve Telekom Albania, shoqëria jonë, në kuadrin e veprimtarisë së saj në fushën e telefonisë celulare, ju paraqet më poshtë një përmbledhje të kushteve të ofruara për blerjen e produkteve "Open Box".

**KUSHTET DHE AFATET KOHORE**

Ky telefon është nga kategoria "Open Box", e cila përmban telefona dhe pajisje të hapur nga kutia e prodhuesit. Telekom Albania garanton që këto pajisje nuk janë të përdorura. Produktet e "Open Box" janë oferta ekskluzive nga Telekom Albania.

Pas blerjes së pajisjes, në rast defekti ju mund të ktheni produktin në një nga dyqanet Telekom deri në 15 ditë pas blerjes. Perfaqesuesi i shitjes do t'ju udhëzojë më tej për procesin e ndjekur nga Telekom Albania për kontrollin dhe riparimin e pajisjes suaj. Brenda 5 ditësh nga kthimi i pajisjes, ju do të njoftoheni për statusin e kërkesës suaj si dhe për kohën e kthimit të pajisjes (gjithsesi kjo kohë nuk do të jetë më shumë se 30 ditë).

Për procesin e kontrollit dhe riparimit:

1. DOA (dead on arrival/difekt në blerje) - klientit i zëvendësohet pajisja me një të re, ose me kthimin e shumës së parave nëse nuk ka pajisje të njëjtë me atë të porositur nga klienti. Pajisja zëvendësuese duhet të kontrollohet nga skuadra e Kujdesit ndaj Klientit për t'u siguruar funksionaliteti paraprakisht. Ky proces zgjat 5 ditë.



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

2. Defekte që mund të riparohen nga njësia për Kujdesin ndaj Klientit të Telekom Albania. Abonenti njoftohet brenda 5 ditësh nga kompania për statusin dhe për kohën kur mund të tërheqë pajisjen nga dyqani përkatës.
3. Defekte që kanë nevojë për palën e tretë të autorizuar për shërbimin. Kjo e fundit do të riparojë në një mënyrë dhe kohë të arsyeshme tregtare defektet. Abonenti njoftohet brenda 5 ditësh nga Telekom Albania për statusin dhe për kohëzgjatjen e riparimit nga partneri i Telekom Albania.
4. Abonenti mund të kontrollojë statusin e kërkesës së tij në çdo kohë duke telefonuar në 142, 139 ose 144.

**SI VEPROHET PËR TË MARRË SHËRBIMIN E MËSIPËRM:**

Nëse ju dëshironi të bëni një kërkesë sipas këtyre kushteve, ju lutem ktheni Produktin tuaj në dyqanin Telekom Albania që ju ka dorëzuar Produktin pasi e keni blerë atë.

Kur bëni një kërkesë do të jetë e nevojshme të vini në dispozicion:

- a) Produktin
- b) Dëshmi origjinale të blerjes, që tregon qartë emrin dhe adresën e shitësit, datën dhe vendin e blerjes, llojin e produktit dhe IMEI ose numra serial të tjerë.

**ÇFARË NUK MBULOHET NGA KËTO KUSHTE TË SHËRBIMIT:**

1. Nuk mbulohen:

- a) konsumimi normal i pajisjes (duke përfshirë, konsumimin e lenteve të kameras, baterisë apo ekranit),
- b) defekte të shkaktuara nga trajtimi pa kujdes (duke përfshirë, defekte të shkaktuara nga sendet e mprehta, nga përkulja, shtypja ose rënia, etj), ose
- c) defekte ose dëme të shkaktuara nga keqpërdorimi i produkteve, duke përfshirë përdorimin që është në kundërshtim me udhëzimet e vëna në dispozicion nga Telekom Albania /prodhuesi (p.sh. siç është përcaktuar në manualin e përdoruesit të Produktit) dhe/ ose
- d) akte të tjera përtej kontrollit të arsyeshëm nga Telekom Albania.

2. Nuk mbulohen defektet apo defektet e pretenduara të shkaktuar nga fakti që Produkti është përdorur me, apo lidhur me, çdo produkt, aksesor, software dhe/ose shërbime që nuk prodhohen apo furnizohen nga Telekom Albania, apo kur



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

Produkti është përdorur për qëllime të ndryshme nga qëllimi fillestar. Defektet mund të shkaktohen nga viruset, e marra prej veprimeve të përdoruesit ose nga aksesit i paautorizuar i një pale të tretë në shërbimet, llogaritë apo sistemin kompjuterik. Ky akses i paautorizuar mund të realizohet përmes "hacking", "password mining" ose përmes një shumëllojshmërie mjetesh të tjera.

3. Këto kushte nuk janë të ekzekutueshme në qoftë se Produkti është hapur, modifikuar ose riparuar nga ndokush tjetër përveç një qendër shërbimi e autorizuar nga Telekom Albania, nëse ajo është riparuar duke përdorur pjesë këmbimi të paautorizuara ose nëse numri serial i Produktit, apo numri i IMEI, janë hequr, shuar, ndryshuar ose janë të palexueshëm dhe kjo do të përcaktohet nga gjykimi i Telekom Albania.

**SHËNIMI!** Produkti juaj është një pajisje elektronike e sofistikuar. Telekom Albania ju inkurajon shumë të familjarizoheni me manualin e përdoruesit dhe udhëzimet e vëna në dispozicion me dhe për Produktin. Ju lutemi vini re se Produkti mund të përmbajë ekran/e me precizion të lartë, lente kamere dhe pjesë të tjera si këto, të cilat mund të gërvishen ose dëmtohen nëse nuk trajtohen me shumë kujdes.